

**Vendim nr. 62 datë 23.09.2024**

**(V-62/24)**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga : Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji , Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 23.09.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 17 (K) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUESE:**           **KRYETARJA E GJYKATËS KUSHTETUESE**, zonja Holta Zaçaj.

**OBJEKTI:**           **Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese, zonjës Elsa Toska.**

**BAZA LIGJORE:** Neni 127, pikat 1, shkronja “c” dhe 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 8, pika 3 dhe 9, pikat 1, shkronja “c” dhe 2 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoji relatimin e bërë nga Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) dhe administroi dokumentacionin e çështjes,

**V Ë R E N:**

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr. 133/2019, datë 11.11.2019 ka vendosur: *“Zonja Elsa Toska zgjidhet anëtare e Gjykatës Kushtetuese, për vakancën e plotë të shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 12.02.2018.”*

2. Në datën 14.11.2019 zonja Elsa Toska ka bërë betimin para Presidentit të Republikës.

3. Në datën 19.09.2024 zonja Elsa Toska, bazuar në nenin 127, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe nenin 9, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 8577/2000, i ka paraqitur Kryetares së Gjykatës aktin “Njoftim i dhënies së dorëheqjes nga funksioni i gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese”, për arsye personale.

4. Në datën 20.09.2024 Kryetarja e Gjykatës ka paraqitur përpara kësaj Gjykate kërkesë për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese, zonjës Elsa Toska, për shkak të dorëheqjes.

5. Si raste të mbarimit të mandatit kushtetues neni 127, pika 1, shkronja “c”, i Kushtetutës parashikon edhe atë kur gjyqtari i Gjykatës “*jep dorëheqjen*” dhe sipas pikës 2 të po këtij neni mbarimi i mandatit deklarohet me vendim të po kësaj Gjykate. Kjo dispozitë është zbrërthyer më tej në nenin 9, pikat 1, 2 dhe 3, të ligjit nr. 8577/2000. Sipas pikës 2, fjalia e dytë, të nenit 9 të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit bëhet nga Kryetari i Gjykatës, kurse sipas pikës 3 të tij Kryetari i Gjykatës, jo më vonë se 3 muaj përpara përfundimit të mandatit të një gjyqtari, sipas pikës 1, shkronjat “a” dhe “b”, të këtij neni, si dhe menjëherë në rastet e mbarimit të mandatit përpara afatit ligjor, njofton organin e emërtesës për vendin vakant.

6. Gjykata, bazuar në dispozitat e mësipërme, pasi konstatoi faktin e paraqitjes së dorëheqjes së gjyqtares Elsa Toska nga funksioni kushtetues dhe duke vlerësuar se dorëheqja është një akt vullneti dhe shkak kushtetues, sipas parashikimeve të nenit 127, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, për mbarimin e mandatit përpara përfundimit të afatit kushtetues të tij, çmon se kërkesa e paraqitur nga Kryetarja është e bazuar dhe se ndodhet në kushtet e deklarimit të mbarimit të mandatit të gjyqtares Elsa Toska.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 127, pikat 1, shkronja “c” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe neneve 8, pika 3 dhe 9, pikat 1, shkronja “c” dhe 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

### **V E N D O S I:**

- Deklarimin e mbarimit të mandatit përpara afatit të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese, zonjës Elsa Toska, në datën 23.09.2024, për shkak të dorëheqjes.
- Njoftimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë si organi i emërtesës.

- Njoftimin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi menjëherë.

**Marrë më 23.09.2024**

**Shpallur më 23.09.2024**